



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:041594
Datë: 11.01.2019
Numri i dokumentit: 00203340

P.nr. 1118/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku, në çështjen penale kundër të pandehurit - A. A.i, për shkak të veprës penale: lëndim i rëndë trupor, nga neni 189 par.1, të KPRK, si dhe K. A.i, për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1, të KPRK, sipas aktakuzës së PP/II. nr.2324/17, të dt. 25.10.2017 , pas mbajtjes së seancës publike për shqyrtimin e marrveshjes mbi pranimin e fajësisë, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ardian Hajdaraj , të pandehurve A. A.i dhe K. A.i, mbrojtësve të tyre të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Bajram Lajçi dhe av. Arben Kelmendi të dëmtuarve E. B. dhe S. B. , në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.11.01.2019, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

A. A.I, i lindur me ..., në fsh. ..., K. Pejë, ku edhe tani jeton, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr..., lëshuar nga MPB-Republika e Kosovës, i biri i D. dhe nënës M., e gjinisë L., ka të kryer Fakultetin e Edukimit, me profesion-profesor, i martuar, baba i 6 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, posedon tel.nr., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

K. A.I, i lindur me ..., në Pejë, me vendbanim në fsh. ..., K. Pejë, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr..., lëshuar nga MPB-Republika e Kosovës, i biri i A.it dhe nënës V., e gjinisë K., ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, posedon tel.nr. ..., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTORË

Për shkak se:

I pandehuri A. A.i

Me dt. 29.09.2017 rreth orës 16:15 në fshatin ... K-Pejë me dashje dhe me mjete të përshtatshëm i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarit -E. B. nga fshati ... K-Pejë, në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari E. se bashku me vëllain e tij të dëmtuarin S. dhe djalin e vëllait fëmiun 5 vjeçar ishin me automjetin –traktor në rrugën e fshatit, aty janë ndalur të pandehurit me automjetin e tyre golf IV- nga automjeti i pandehuri A. ju kishte thënë të dëmtuarve “përse me keni dal në rrugë dhe jeni duke me shikuar shtrembër, të dëmtuarit kanë vazhduar që të lëvizin me automjetin e tyre traktor në drejtim të malit, ku te pandehurit më pas janë kthyer me automjetin e tyre duke i ndjek pas dhe sapo afrohen tek të dëmtuarit i pandehuri A. merr një mjetë -vaservag metali dhe e godet të dëmtuarin E. në këmbën e djathtë dhe në dorën e majtë, me qrastë si pasoj e goditjes i dëmtuari pëson lëndim të rëndë trupor si thyerje të këmbës së djathtë.

-me çka ka kryer veprë penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par 1 të KPRK-së.

I pandehuri K. A.i

Me dt. 29.09.2017 rreth orës 16:00 në fshatin K-Pejë me dashje dhe me mjete të përshtatshëm i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit -S. B. nga fshati K-Pejë, në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari S. se bashku me vëllain e tij dhe djalin e vëllait fëmiun 5 vjeçar ishin me automjetin –traktor në rrugën e fshatit, aty janë ndalur të pandehurit me automjetin e tyre golf IV- i pandehuri A. ju kishte thënë të dëmtuarve “përse me keni dal në rrugë dhe jeni duke me shikuar shtrembër, i pandehuri K. sapo arrin që tu ofrohet të dëmtuarve e godet të dëmtuarin me grushta dhe shqelma ne pjesë të ndryshme të trupit

-me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 41, 42 par. 1, pika 1.1 dhe 1.2, 43 par.1, pika 1.2, 45, 47, 49 par 1 pika 1.1, 51, 52, 73, 74, 75 par.1, pika 1.3, neni 188 par.1, 189 par1 të KPRK-së, nenit 233 par.21 dhe 365 të KPP-së, të pandehurve iu shqipto

I.Të pandehurin A. A.i

E GJYKON

Me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.

Me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burg, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i zëvendësohet me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 3000 (tremijë) €, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguajë në afat prej 3 (tre) muaj, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri refuzon që ta paguajë gjobën, ose nuk e paguan gjobën në tërësi, atëherë, i njëjti do të dërgohet në vuajtje të dënimit të përcaktuar më lartë.

I pandehuri obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 50(pesëdhjetë) €, dhe të paushallit gjyqësor në shumë 30 (tridhjetë) €, gjithsej 80 (tetëdhjetë) €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari E. B. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

II. Të pandehurit K.A.i

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehuri K.A.i i përcaktohet dënim me burg në kohëzgjatje prej një (4) muajve, mirëpo ky dënim nuk do te ekzekutohen në rast se i akuzuari brenda periudhës një (1) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

I pandehuri obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 50(pesëdhjetë) €, dhe të paushallit gjyqësor në shumë 30 (tridhjetë) €, gjithsej 80 (tetëdhjetë) €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari S.B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngrit aktakuzë Pejë, PP/II. nr.2324/17, të dt. 25.10.2017, kundër të pandehurit A.A.i, për shkak të veprës penale: lëndim i rëndë trupor, nga neni 189 par.1, të KPRK, si dhe K.A.i, për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1, të KPRK.

Me datë 23.10.2017, prokurori i shtetit Sanije Gashi Seferi të pandehurit A.A.i dhe K.A.i , në prezencën e mbrojtësve të tyre av. Bujar Berdyna dhe Arben Hoti kanë lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë, ne të cilën të pandehuri ka pranuar fajësinë për veprat penale të cekur më lartë, ndërsa prokurori i shtetit ka pranuar që të njëjtëve të ju shqiptohet dënimi i cekur në marrëveshje .

Gjykata me dt. 08.01.2019 ka mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ku prezent kanë qenë prokurori i shtetit Ardian Hajdaraj , të pandehurit A. A.i dhe K.

A.i, mbrojtësit e tyre të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Bajram Lajçi dhe av. Arben Kelmendi të dëmtuarit E.B. dhe S.B. .

Me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, sipas nenit 247 par 1, lidhur me nenin 233 par 18 të KPP-së, gjykata fillimisht ka përcaktuar se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën e veprës penale e cila iu vihet në barrë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe se nuk kanë qenë të detyruar, apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të cilat paraqitën në aktakuzë dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 253 par 1 të KPP-së.

Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë Prokurori i shteti, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre deklaruan se të njëjtit mbesin prapa marrëveshjes së lidhur me dt. 23.10.2017 dhe i propozuan gjykatës që të pandehurve tu shqiptohet dënimi si në marrëveshje.

Të dëmtuarit deklaruan se nuk e kundërshtojnë marrëveshjen për pranimin e fajësisë , mirëpo të njëjtit paraqesin kërkesën pasurore juridike.

Gjykata pasi është bindur se janë plotësuar kushtet nga neni 233 par.18, të KPP-së, ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe në pajtim me marrëveshjen, gjykata të pandehurve iu ka shqiptuar dënimin të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me faktet e ofruara, si dhe me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurve A. A.i qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale lëndim i rëndë trupor, nga neni 189 par.1, të KPRK, ndërsa në veprimet të të pandehurit K. A.i, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale : lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1, të KPRK-së

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurve dhe të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Sa i përket fajësisë të pandehurit ishin të vetëdijshëm për veprën e vet dhe e kanë dëshiruar kryerjen e saj.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe larësin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se: i akuzuari A.A.i pati sjellje korrekte para gjykatës dhe nuk ishte i dënuar me parë për vepër penale, gjithashtu edhe i pandehuri K.A.i pati sjellje korrekte para gjykatës dhe nuk ishte i dënuar me parë për vepër penale, ndërsa rrethona posaçërisht lehtësuese për të pandehurit gjykata nuk gjeti, e po ashtu nga rrethanat rënduese për të pandehurit gjykata nuk gjeti asgjë, po ashtu mori parasysh edhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të lidhur me mes të pandehurve dhe Prokurorisë

Gjykata ju shqiptoi dënimin të pandehurve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën që personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale dhe për paushallin gjyqësor, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit i udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM
P.nr.1118/17 dt. 11.01.2019

Sekretarja juridike
Fitore Bojku

Gj y q t a r i
Shaqë Curri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pas marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate